



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:065118

Datë: 25.05.2019

Numri i dokumentit: 00328206

P. nr.761/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. L. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2-1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/II.nr.977/18 të datës 29.10.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **25.05.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B. L. nga Gjakova, Rr " . . . "**, data e lindjes . . . , ne Gjakovë, i biri i H. dhe i nënës F. e gjinisë D.,ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se dobët ekonomike, i pa punë, i pa martuar, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, me ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- me dt. 16.07.2018 rreth orës 22.30min. ne parkun e qytetit te Gjakovës ,ne afërsi te gjimnazit . . . , pas një kontrolli te ushtruar nga patrulla e policisë,njësia DHTN ne Gjakovë , tek i dyshuari është gjetur pa autorizim se posedon narkotik ,substancë psikotrope ose analoge te shpallur te rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për barna narkotike ,substancia psikotrope dhe prekusore nr. 02/L-128 , dhe atë te llojit ne formë bari ngjyre e gjelbër ,e dyshuar per marihuana ,ku nga ekzaminimi laboratorik i forenzikes është konstatuar se dëshmia #1. Kishte ne posedim 0.15gr. substancë narkotike e llojit kanabis (marihuan).

-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2 -1të KPRK-ës,

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,41,43,46,73 të KPRK-ës, dhe nenit 275/2 -1të KPPK-ës, dhe nenit 365 te KPPK-së te akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumën prej **200(dyqind)euro**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së ,atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **10 (dhjet) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)euro**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, si dhe në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej **20,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë .

Gjykata bazuar ne nenin 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7, të akuzuarit i shqipton masën e :

MARRJA E SENDEVE

Konfiskohet substanca narkotike e llojit kanabis (marihuanë) me peshë prej peshë neto prej 0.15 gr. që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me 16.07.2018 .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.977/18 të datës 19.10.2018, ka akuzuar të akuzuarin B. L. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2-1 të KPRK-ës,

Gjykata konstaton se me aktvendimin P.nr. 761/18 te dt. 10.04.2019 ka pezulluar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me qene se i akuzuari B. L. nuk ka marr pjesë ne seancën e caktuar për te cilën është lëshuar urdhëresë për shoqërim me detyrim ,mirëpo sipas njoftimit nga st. policor me dt. 08.04.2019 me nr. 04/1-08-GJ-S-153/19 ,gjykata është njoftuar se i akuzuari ndodhet jashtë shtetit në Kroaci,e këtë informatë e kanë marr nga vëllai i tij G. L. me nr. tel . . . , për te cilën gjykata ka lëshuar edhe urdhër arrest .

I akuzuari është ndaluar nga st. policor ne Gjakovë me dt. 24.05.2019 ,lidhur me urdhër arrestin , i njëjti është paraqitur sot ne gjykatë me dt. 25.05.2019 për çka gjykata te njëjtin do ta procedon dhe do te behet tërheqja e urdhër arrestit.

Gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor të mbajtur me dt. 25.05.2019, prokurori i shtetit Anton Hasanaj , bene leximin e aktakuzës PP/II.nr. 977/18 të dt.29.10.2018 dhe deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari B. L. ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet, duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë te procedurës jam penduar per veprën penale te kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm me qene se muajt e fundit kam qene ne Kroaci duke punuar per çka edhe mendojë se jam rehabilituar , andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur ne gjykate , premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla dhe do te jem me i kujdesshëm si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike te pranimi te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. L. : -- me dt. 16.07.2018 rreth orës 22.30min. ne parkun e qytetit te Gjakovës ,ne afërsi te gjimnazit . . . , pas një kontrole te ushtruar nga patrulla e policisë, njësia DHTN ne Gjakovë , tek i dyshuari është gjetur pa autorizim se posedon narkotik ,substancë psikotrope ose analoge te shpallur te rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për barna narkotike ,substancia psikotrope dhe prekusore nr. 02/L-128 , dhe atë te llojit ne formë bari ngjyre e gjelbër ,e dyshuar per marihuana ,ku nga ekzaminimi laboratorik i forenzikes është konstatuar se dëshmia #1. Kishte ne posedim 0.15gr. substancë narkotike e llojit kanabis (marihuan).

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban propozim akuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPP, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit . Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim , gjendjen e dobët ekonomike të akuzuarit, pendimin e tij , premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale si dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjkata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me gjobë në shumën prej **200(dyqind)euro**, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari. dhe se ky sanksion do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të llojit kanabis (marihuanë), me peshë prej 0.15 gr. , që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 16.07.2018 ,u murr komform neni 275 par.5 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7 neni 69 te KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € ,është bazuar në dispozitat e neni 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimin numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 761/18 më datë 25.05.2019

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh** , nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:065118
Datë: 25.05.2019
Numri i dokumentit: 00328206